



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/76
Datë: 21.11.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Vendoset masa prej 100% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina.
2. Pavarësisht origjinës së mallit të paraparë në paragrafin 1 të këtij vendimi, masa prej 100 % nuk aplikohet për markat e njohura tregtare të vendeve tjera cilat prodhohen në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, të cilat janë pjesë e aneksit të bashkangjitur me këtë vendim.
3. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës që të ndalojë importin dhe hyrjen në treg të të gjitha produkteve të cilat në etiketën apo deklaracionin e tyre kanë përmbajtjen e: Importues / Distributor / Përfaqësues / Prodhues / apo edhe ndryshe, për dhe në "Kosovë e Metohi", "Kosovo Unmik", "Kosovo 1244", "Kosovo Rezoluta 1244" sikurse edhe ato në të cilat përdorin vetëm emrat e qyteteve pa emrin e shtetit, apo edhe çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin kushtetues të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet MTI - Inspektorati i Tregut dhe Inspektoratet Komunale që të obligojnë të gjithë operatorët ekonomik t'i largojnë nga tregu të gjitha produktet të cilat në etiketën apo deklaracionin e tyre kanë përmbajtjen e: Importues / Distributor / Përfaqësues / Prodhues / apo edhe ndryshe, për dhe në "Kosovë e Metohi", "Kosovo Unmik", "Kosovo 1244", "Kosovo Rezoluta 1244" sikurse edhe ato në të cilat përdorin vetëm emrat e qyteteve pa emrin e shtetit, apo edhe çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin kushtetues të Republikës së Kosovës.
5. Obligohet Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe institucionet tjera relevante të zbatojnë masa të njëjta ndaj Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës për sa i përket dokumenteve dhe certifikatave që kërkohen për tregti (Dokumentet dhe certifikatat i referohen analizave të testimit, analizave laboratorike, certifikatave sanitare dhe fito-sanitare, barkodit të produkteve kosovare).

6. Obligohet Ministria e Financave, Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe institucionet tjera relevante për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 01/74 i datës 06.11.2018.
8. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

ANEKSI

NR	Emri i subjektit	Brendi	Prodhuar në
1	Coca Cola HBC	Coca cola	Serbi
2	Ymalko	Ytong (Xella)blloka	Serbi
3	Meridian Corporation	Rouch-Bravo	Serbi
4	Elkos SHPK	Henkel/Persil	Serbi
5	Lactalis shpk	Dukat	Bosne
6	Meridian Corporation	Tuborg	Serbi
7	Gorenje Niti-Tiki	Gorenje	Serbi
8	Delfin LTD	Meggle	Bosne
9	Fluidi	Jaffa - PIJE JO ALKOOLIKE	Serbi